



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Përparim Rama, Kryetar i Kryeqytetit të Prishtinës Fehmi Kupina, Kryesues i Kuvendit të Kryeqytetit të Prishtinës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erbllin Hetemi, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 22/10/2024 Nr. 020-631
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit të Monitorimit Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Kërkesë për shqyrtim të ligjshmërisë së aktit të Kryeqytetit së Prishtinës	
Lloji i aktit:	Vendimit	

I nderuar Kryetar,
I nderuara Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 14/2024 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimin Nr. 14.020/04.129312/24 për miratimin e kërkesës së ndërmarrjes publike lokale "Sport Marketing SH.A" për organizimin e tregut veror

I nxjerr më datën: 02.10.2024

I portokoluar për shqyrtim në MAPL më datë: 11.10.2024

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit vlerëson se akti është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Arsyetim

Kryetari i Kryeqytetit të Prishtinës me datën 02.10.2024, ka nxjerr vendimin Nr. 14.020/04.129312/24 për miratimin e kërkesës së ndërmarrjes publike lokale "Sport Marketing SH.A" për organizimin e tregut veror. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është njoftuar përmes ankesës së pranuar pranuar me datën 10 Tetor 2024 lidhur me nxjerrjen e aktit nga Kryetari i Kryeqytetit të Prishtinës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me të pranuar njoftimin për nxjerrjen e aktit nga Ekezekutivi i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës- Prishtinës dhe duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale neni 80 paragrafi 2 me të cilën është përcaktuar se "Autoriteti mbikëqyrës ka të drejtë të mbikëqyrë çdo akt i cili nuk është kontrolluar sipas procedurave të shqyrtimit të detyrueshëm, brenda 30 ditësh pas pranimit të listës së përmendur në paragrafin 1 të këtij neni" shqyrton ligjshmërinë e tij si në vijim.

MAPL konstaton, se Vendimit Nr. 14.020/04.129312/24 nuk përmban në preambulë Rregulloren nr. 01-463/01-227577/23 për përcaktimin e procedurave dhe formave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për me pak se një vitë të datës 01.12.2023 akt me të cilën Kryeqyteti i Republikës së Kosovës /Prishtinë ka përcaktuar "proceduar të brendshme për dhënien në shfrytëzim të pronës me pakë se një vitë" si dhe neni gjashtë (6) i vendimit ka përcaktuar se "hyrja në fuqi relaizohet në momentin e nënshkrimit të tij" duke anshkaluar dërgimin e aktit autoritetit mbikëqyrës për shqyrtimit të ligjshmerisë është në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale nenin 80.

Rregulloreja nr. 01-463/01-227577/23 për përcaktimin e procedurave dhe formave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për me pak se një vitë të datës 01.12.2023 e Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës ka përcatuar në nenin tetë (8) paragrafi 2 se "Kërkesën për dhënien në shfrytëzim të hapësirat publike i drejtohen Drejtorisë së Shërbimeve publike ndërsa shqyrtimin dhe vendosjen për çështjen e benë komisioni përkatës" ndërsa në vendimin 14.020/04.129312/24 nenin katër (4) kjo e drejtë është rezervuar vetëm për Kryetarin e Kryeqytetit.

Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale në nenin 80 paragrafi 1 ka përcaktuar se "Kryetari i komunës i dërgon autoritetit mbikëqyrës listën e të gjitha akteve të miratuara nga kryetari dhe kuvendi në muajin paraprak, deri më datën 10 të çdo muaji." si dhe në paragrafi 2 në po të njëtin nen ka përcaktuar se "Autoriteti mbikëqyrës ka të drejtë të mbikëqyrë çdo akt i cili nuk është kontrolluar sipas procedurave të shqyrtimit të detyrueshëm, brenda 30 ditësh pas pranimit të listës së përmendur në paragrafin 1 të këtij nen". Në rastin konkret me vendimin Nr. 14.020/04.129312/24 përkatësishit neni 6 qe përcakton se "Ky vendim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të tij" përbën shkelje për faktin se "anshkalon dërgimin e aktit autoritetit mbikëqyrës" si dhe kjo dispozitë "anashkalon të drejtën e autoriteti mbikëqyrës për shqyrtimit të ligjshmerisë" duke prodhuar efektet juridike nga momenti i nënshkrimit.

Ministria e Admsinitimt të Pushtetit Lokal bazuar në të lartcekurat kërkon nga Kryetari i Kryeqytetit të Prishtinës dhe Kuvendi i Kryeqytetit qe të ndërmarrin veprime dhe brenda afatit ligjor të rishqyrtojë aktin dhe të harmonizoj më legjislacionin në fuqi dhe konform mandatit qe kanë si organe komunale.



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Za:	Përparim Rama, gradonačelnik glavnog grada Priština Fehmi Kupina, predsedavajući Skupštine glavnog grada Priština	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jeton Qela, generalni sekretar MALS-a	
Od:	Erblin Hetemi, vd. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština /MALS	Datuma: 22.10.2024 br. 020-631
Odgovorni službenici: 1. Službenik za potvrđivanje pravne procene: 2. Službenik za izradu pravne ocene	Xhevat Tafa, rukovodilac odseka za monitorisanje opština Driton Xhafa, službenik za monitorisanje opština	
Lënda:	Zahtev za preispitivanje zakonitosti akta glavnog grada Priština	
Lloji i aktit:	Odluka	

Poštovani/a gradonačelnice,

Poštovani/a predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 14.020/04.129312/24 o odobrenju zahteva lokalnog javnog preduzeća „Sport marketing SH.A“ za organizovanje letnje pijace
Usvojena dana, 02.10.2024.god
Predložena na razmatranje u MALS dana, 11.10.2024.god

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da opštinski akt nije u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Gradonačelnik Glavnog grada Priština je dana 02.10.2024. godine, doneo Odluku br. 14.020/04.129312/24 o odobrenju zahteva lokalnog javnog preduzeća „Sport marketing SH.A“ za organizovanje letnje pijace. Ministarstvo administracije lokalne samouprave je putem prijema pritužbe dana, 10. oktobra 2024. godine, obavešteno u vezi sa odobrenim aktom od strane gradonačelnika glavnog grada Priština.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave je primilo obaveštenje za odobrenju akta od strane Izvršne vlasti glavnog grada Republike Kosovo – Priština i na osnovu Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, član 80, kojim se utvrđuje da „Nadzorni organ ima pravo da vrši nadzor nad svakim aktom koji nije proveren u skladu sa obaveznim procedurama razmatranja, u roku od 30 dana od dana prijema“ razmatra zakonitost, kao u nastavku.


MAIS konstatuje da Odluka br. 14.020/04.129312/24 ne sadrži u preambuli Uredbu br. 01-463/01-227577/23 o utvrđivanju postupaka i obrazaca davanja na korišćenje nepokretne opštinske imovine manje od godinu dana od, 01.12.2023.godine, aktom koji je glavni grad Kosova/Priština utvrdilo *“unutrašnje procedure davanja na korišćenje manje od godinu dana”* kao i članom šest (6) odluke je utvrđeno da „stupanje na snagu ponovo stupa na snagu u trenutku potpisivanja akta“ zaobilazeći slanje akta nadzornom organu na preispitivanje zakonitosti je u suprotnosti sa Zakonom br. 03/L-040 za lokalnu samoupravu, član 80.

Uredba br. 01-463/01-227577/23 o utvrđivanju procedura i obrazaca davanja na korišćenje nepokretne opštinske imovine manje od godinu dana od, 01.12.2023.godine Skupštine glavnog grada Kosova, utvrđeno je u članu osam (8) stavu 2 da, *“Zahtev za davanje na korišćenje javnih površina se upućuje Upravi za javne usluge dok, razmatranje i odluku po ovom pitanju donosi nadležna komisija”*, dok u Odluci 14.020/04.129312/24 član četiri (4) ovo pravo je rezervisano samo za gradonačelnika glavnog grada.

Zakon br. 03/L-040 za lokalnu samoupravu u članu 80 stav 1 odredio je da „ Gradonačelnik opštine dostavlja nadzornom organu spisak svih akata koje su usvojili gradonačelnik i skupština u prethodnom mesecu, do 10. svakog meseca.“ kao i stavom 2. u prvom članu utvrđeno je da „Nadzorni organ ima pravo da vrši nadzor nad svakim aktom koji nije kontrolisan po proceduri, obaveznog pregleda, u roku od 30 dana od dana prijema liste iz stava 1, ovog člana ispod“. U konkretnom slučaju odlukom br. 14.020/04.129312/24 u vezi sa članom 6 koji kaže da *„Ova odluka stupa na snagu u trenutku njenog potpisivanja“* predstavlja povredu jer *„prevazilazi slanje akta nadzornom organu“* kao i odredba *“prevazilazi pravo nadzornog organa na kontrolu zakonitosti”* koja proizvodi pravno dejstvo od momenta potpisivanja.

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave zahteva od gradonačelnika glavnog grada i Skupštine glavnog grada preduzimanje radnji i u zakonskom roku razmotriti i usaglasiti akt sa zakonodavstvom na snazi u skladu sa mandatom koji imaju kao opštinski organi.

From: Gezim Svecla
Sent: 10 October 2024 15:02
To: Shkrimorja Mapl
Cc: Elbert Krasniqi; Mergim Neziraj
Subject: Kërkesë për shqyrtim të ligjshmërisë

		
HYRËSE - ULAZNA - JNCOMING		
REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS Vlada Kosova / GOVERNMENT OF KOSOVA		
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministritvo Lokalne Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration		
Data: Datum: Date: 11.10.2024		
Hjeshi organizatave	Hr. i Lendjes	Vlारा
-VI-	020-631	

Të nderuar,

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, dhe dokumente tjera ligjore, udhëzime administrative dhe rregullore, mbi shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve të komunave dhe vendimeve të Kryetarëve të Komunave, ju lutem ta shqyrtoni vendimin nr. 4-020/04-129312/24 të datës 02.10.2024, të Kryetarit të Prishtinës (vendimin e kontestuar e gjeni të bashkangjitur)

Në vlerësimin tonë Kryetari i Prishtinës me këtë vendim i ka tejkaluar kompetencat e veta që i takojnë me ligj, duke shpërndarë autorizime të cilat ligjërisht nuk i ka. Gjithashtu për neve është problematike edhe afati i hyrjes në fuqi të këtij vendimi, i cili është specifikuar në Pikën VI të të njëjtit.

Ju lutem që ta vlerësoni sa më parë ligjshmërinë e këtij vendimi dhe t'i ndërmerrni të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e ligjshmërisë në vendimarrje në Komunën e Prishtinës.

(Ju lutem ta konfirmoni pranimin e këtij emaili)

Me respekt,

Gezim Svecla,

Drejtuës i Grupit të Këshilltarëve Komunal të Lëvizjes VETËVENDOSJE! në KK të Prishtinës.

email: gezimsvecla@rks-gov.net

mob: +383(0)49702702



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/04-129312/24, më 02 OCT 2024

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28/04 qershor 2008) dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës, merr këtë:

V E N D I M

- I. MIRATOHET Vendimi sipas kërkesës së Ndërmarrjes Publike Lokale “Sport Marketing” SH.A. për organizimin e tregut veror “Akull N’verë dhe tregut dimëror “verë N’dimër”.
- II. Organizimi i tregut veror “Akull N’verë dhe tregut dimëror “ verë N’dimër” me të gjitha të drejtat dhe detyrimet i takon NPL “Sport Marketing” SH.A.
- III. Kryeshefi dhe Bordi i NPL “Sport Marketing” SH.A vendosin për mënyrën e organizimit dhe zhvillimin këtij aktiviteti në zona të caktuara në Kryeqytet në pajtim me planin e organizimit.
- IV. Plani i vendosjes së shtëpizave duhet të merr aprovimin paraprak nga Kryetari i Kryeqytetit në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi, obligohen Ndërmarrja Publike Lokale “Sport Marketing” SH.A dhe Komuna e Prishtinës.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të tij.

KRYETARI I KRYEQYTETIT

Përparim Rama

U DORËZOHET:

- Ndërmarrjes publike lokale Sport Marketing SH.A.;
- Qendrës për shërbime me qytetarë; dhe
- Në dosje.

